



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kačanik



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Kaçanik, 03. 09. 2025

I	Data	03.09.25	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
01	104/02	22216		X

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve

1. **Komuna e Kaçanikut**, duke u bazuar në Rregulloren MF- Nr. 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, fton gjitha organizatat jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës, e me bazë në Komunën e Kaçanikut, për aplikim për mbështetje financiare-subvencionim të tyre, programi i punës i të cilave është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare.
 2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publik, mund të aplikojnë me projektet e tyre të cilat duhet të kenë për objekt zbatimin e aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen e grupeve në nevojë dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, respektivisht të ushtrojnë aktivitete që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe këshilluese për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.
 3. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 4,000.00 euro.
- Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 1,000.00 euro, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 4,000.00 euro.
4. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve (aplikacioneve) është 15 ditë pune, fillon me datën 04. 09. 2025 dhe përfundon me datën 24. 09. 2025.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ- të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare, webfaqja:

<https://kacanik.rks-gov.net/shpalljet/>

(rubrika: **SHPALLJET**)

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen tek:

Objekti i Komunës, sporteli nr. 8, kati i Parë

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

Kryetari i Komunës



Besim Ilazi